



**RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES  
PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

**Fakulteti Shkencave Matematike-Natyrore**

**Lëndët/Pozitat: Departamenti i Biologjisë**

1. Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtje të ushtrimeve nga lëndët: Fizilogjia e bimëve (Ekologji) sem. III 2+2 për dy grupe 4 orë, Fizilogjia e bimëve (Biologji) sem. IV 2+2 për tri grupe 6 orë,

**Komisioni vlerësues (prej 5 ose 3 anëtarëve):**

1. Prof. Assoc. Dr. Bekim Gashi, kryetar
2. Prof. Dr. Kemajli Bislimi, anëtar
3. Prof. Assoc. Dr. Hazbije Sahiti, anëtare

**Kandidatët e paraqitur sipas pozitive/lëndëve të shpallura me thirrjen publike:**

Pozita/lëndët: **Departamenti i Biologjisë, pozita nr. 1.** Një bashkëpunëtor të jashtëm për mbajtje të ushtrimeve nga lëndët: Fizilogjia e bimëve (Ekologji) sem. III 2+2 për dy grupe 4 orë, Fizilogjia e bimëve (Biologji) sem. IV 2+2 për tri grupe 6 orë,

1. Djelza Panxhaj
2. Granit Osaj
3. Erzë Çoçaj
4. Avdyl Bajrami
5. Besnik Dakaj
6. Muhamir Shyqeriu
7. Mirinda Dehari Zeka
8. Bekir Bytyqi

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE  
PRISHTINË

Pranuar me: 30.08.2014			
N. orig	Numer	Sasia	Vlera
01	2855	4	-



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

*(Raporti përmbledhës duhet të përmbajë përshkrimin e përmbledhur dhe emrin e secilit kandidat të paraqitur në pozitën/lëndët përkatëse, dhe arsyelimin e veçantë për kandidatin/ët që propozohen për angazhim si bashkëpunëtorë të jashtëm).*

1. **Djellza Panxhaj** – është lindur më 26.02.1998 në Pejë. Studimet bachelor në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2019 me notë mesatare 8.63. Ndërsa studimet master në po të njëjtin departament në vitin 2021 me notë mesatare 9.82. Ka të publikuar një punim shkencor dhe një pjesëmarrje në një konferencë shkencore në lëminë e gjenetikës. Vitin e kaluar akademik ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtorë e jashtme për ushtrime në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë.
2. **Granit Osaj** - është lindur më 30.01.1993 në Novosellë, Pejë. Studimet bachelor në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2016 me notë mesatare 8.78. Ndërsa studimet master në po të njëjtin departament në vitin 2020 me notë mesatare 9.29. Ka marrë pjesë në një konferencë shkencore. Ka edhe disa dëshmi për trajnime për mësimdhënie parauniversitare.
3. **Erzë Çoçaj** – është lindur më 23.06.1997 në Gjonaj, Prizren. Studimet bachelor në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2019 me notë mesatare 9.43. Ndërsa studimet master në Shkencat Biologjike i ka përfunduar në Universitetin e Camerinos në Itali në vitin 2023 (e nostrifikuar) me notë mesatare 9.77 (e konvertuar nga sistemi Italian, 29.12 nga 30 sa është maksimumi). Bazuar në shtesën e diplomës Master, përveç 120 ECTS për lëndët sipas programit të studimit në Shkencat Biologjike, ajo ka të përfunduar edhe pesë lëndë tjera shtesë me 27 ECTS, si: Metodologjitë dhe Teknologjitë arsimore, Pedagogjia, Pedagogjia speciale dhe Didaktika e inkluzionit, Psikologjia, etj. Në vitin 2023 për një semestër ka qëndruar në Universitetin e Konstanzës në Gjermani me programin Erasmus+, ku ka ndjekur disa lëndë si: Neurobiologjia dhe Sjelja, Biologjia e zhvillimit, dhe





## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

ka fituar edhe 30 ECTS të tjera. Ka të publikuar një punim shkencor si bashkautorë dhe tri pjesëmarrje në konferenca shkencore (në Slloveni, Spanjë dhe Hungari) si bashkautorë. Është anëtare në dy projekte shkencore në laboratorin e Fiziologjisë së bimëve në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës, njëri projekt financohet nga Universiteti i Prishtinës (Project no. 2/963 – 9) dhe tjetri nga MASHTI (Project no. 2/2282).

4. **Avdyl Bajrami** - është lindur më 16.04.1970 në Mushtisht. Progarimin Biologji-Kimi në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë, Universiteti i Prishtinës e ka përfunduar në vitin 2005 me notë mesatare 7.50. Ndërsa studimet master departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2009 me notë mesatare 8.12. Studimet e doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në fushën Bujqësia dhe Mjedis i programin Shkencat Agronomike, i ka përfunduar në vitin 2021 (e nostrifikuar). Ka të publikuar një punim shkencor në revistë në Shqipëri dhe disa pjesëmarrje konferenca shkencore (por në disa raste pa detaje të përmabijës informuese, si: vendi, koha, lloji i takimit, etj.). Ka edhe disa dëshmi për trajnime për mësimdhënie parauniversitare.

5. **Besnik Dakaj** - është lindur më 06.11.1996 në Prizren. Studimet bachelor në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2019 me notë mesatare 9.03. Ndërsa studimet master në po të njëjtin departament në vitin 2023 me notë mesatare 9.41. Ka të publikuar një punim shkencor dhe një pjesëmarrje në një konferencë shkencore. Në vitin akademik 2022/2023 për një semestër ka qëndruar në Universitetin e Camerinos në Itali me programin Erasmus+, ku ka ndjekur pjesë praktike hulumtuese për temën master, dhe ka fituar 30 ECTS. Ka të publikuar një punim shkencor si bashkautorë dhe një pjesëmarrje në një konferencë shkencore si bashkautorë. Ka edhe disa dëshmi për trajnime për mësimdhënie parauniversitare.



## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

---

6. **Muhamir Shyqeriu** - është lindur më 04.01.1986 në Brodosanë. Studimet bachelor në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2010 me notë mesatare 8.58. Ndërsa studimet master në programin e Biologjisë molekulare në departamentin e Biologjisë, FSHN, Universiteti i Tiranës i ka përfunduar në vitin 2012 (e nostrifikuar) me notë mesatare 8.56 (që është rreth 8.2 sipas mesatres së sistemit tonë në UP). Studimet e doktoratës në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, në departamentin e Bioteknologjisë në programin Bioteknologji bimore, i ka përfunduar në vitin 2021 (e nostrifikuar). Sipas CV të kandidatit ka edhe disa pjesëmarrje në konferenca shkencore por që dëshmitë nuk gjenden në dosjen e aplikimit dhe gjithashtu disa punime në proceedings book dëshmitë nuk gjenden në dosjen e aplikimit.
7. **Mirlinda Dehari Zeka** - është lindur më 29.05.1974 në Prishtinë. Studimet themelore në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 1998 me notë mesatare 9.73. Ndërsa studimet e magistraturës në po të njëjtin departament në vitin 2010 me notë mesatare 9.6. Në vitin 2020 ka përfunduar studimet e doktoratës në departamentin e Biologjisë, FSHMN, Universiteti i Prishtinës. Ka të publikuar një punim shkencor dhe ka dy pjesëmarrje në konferenca shkencore. Ka ofruar dëshmi edhe për disa trajnime profesionale që lidhen kryesisht me metodat dhe instrumentet matëse e vlerësuse parauniversitare.
8. **Bekir Bytyqi** - është lindur më 23.09.1993 në Leshanë. Studimet bachelor në programin Teknologjisë Ushqimore me Bioteknologji, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës i ka përfunduar në vitin 2016 me notë mesatare 9.45. Ndërsa studimet master në programin Inxhinierisë së Cilësisë dhe Sigurisë Ushqimore në Universitetin e Debrecentit në Hungari në vitin 2020 (e nostrifikuar) me notë mesatare 4.87 nga 5 sa është maksimumi (që është rreth 9.7 sipas mesatres së sistemit tonë në UP). Në vitin 2021 ka regjistruar studimet e doktoratës Universitetin e Debrecentit në Hungari. Ka të publikuar një punim shkencor si autorë kryesor dhe katër punime shkencore si bashkëautorë. Ka ofruar dëshmi edhe disa dëshmi për trajnime profesionale.





## UNIVERSITETI I PRISHTINËS

### Propozimi dhe arsyetimi:

Bazuar në dokumentet e shkarkuara nga sistemi i aplikimit dhe shqyrtimit të tyre, si dhe mbështetur në Satutin e UP-së (neni 154) dhe Rregulloren për Bashkëpunëtorët e Jashtëm (neni 7 paragrafi 3 dhe 4), komisioni konstaton se:

- kandidatët Besnik Dakaj, Djelza Panxhaj, Granit Osaj dhe Muhamir Shyqeriu, edhe pse formalisht i plotesojnë kushtet dhe kriteret për angazhim nuk propozohen sepse kandidati i porpozuar i plotëson më së miri të gjitha këto,
- kandidatja Mirilinda Dehari Zeka nuk propozohet sepse përgatitja e sajë akademike dhe aktiviteti botues nuk lidhen me lëmin e Fiziologjisë së bimëve dhe moshë e sajë është mbi 40 vjeçe,
- kandidati Bekir Bytyqi nuk propozohet sepse fusha e studimit të tij nuk i përket lëmit të Biologjisë,
- kandidati Avdyl Bajrami nuk propozohet sepse nota mesatare në studimet bazike është më e ulët se 8, moshë është mbi 40 vjeç dhe fusha e studimit nuk përputhet me lëndë ku ia ka konkuruar.
- Ndërsa, bazuar rezultatet e shkëlqyshme që ka treguar gjatë studimeve bachelor (nota mestare 9.43) dhe ato master (nota mestare 9.77), aktivitetin e publikimeve dhe projekteve shkencore (anëtare në dy projekte) të cilat janë në fushën e Fiziologjisë së bimëve, përvojën ndëkombëtare gjatë studimeve master në Itali dhe Gjermani, si dhe moshën e sajë të re, mendojmë se Erzë Çoçaj i plotëson më së miri të gjitha kushtet dhe kriteret për angazhim në këto lëndë. Prandaj, komisioni me kënaqësi propozon që Erzë Çoçaj të angazhohet si bashkëpunëtorë e jashtme për mbajtje të ushtrimeve nga lëndët: Fiziologjia e bimëve (Ekologji) dhe Fiziologjia e bimëve (Biologji).

Nënshkrimet origjinale nga anëtarët e Komisionit vlerësues:

1. Kryetar Prof. Assoc. Dr. Bekim Gashi

2. Anëtar Prof. Dr. Kemajl Bislimi

3. Anëtar Prof. Assoc. Dr. Hazbije Sahiti